



RELACION TEKNIK

PROJEKT KONSERVIMI DHE DRENAZHIMI NË
"PORTËN ME KULLA DHE NIMFEU", QYTETI ANTIK
BUTRINT, SARANDË
FAZA II "PORTA ME KULLA"

Rudina
Papavasili

Digitally signed by Rudina Papavasili
Date: 2021.03.10 10:01:11 +02'00'



PËRMBAJTJA

01_VENDNDODHJA

02_PËRSHKRIM HISTORIK

03_ANALIZA E PËRGJITHSHME E MONUMENTIT

04_PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK DHE TEKNIKA E NDËRTIMIT

05_ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË MONUMENTIT.

06_NDËRHÝRJET RESTAURUESE TË PROPOZUARA

07_BIBLIOGRAFIA E KONSULTUAR





□ 1_VENDNDODHJA



Fig. 1 Foto ajrore ku evidentohet Porta me Kulla





Fig. 2 Lidhja e Sarandes me vendndodhjen e Parkut të Butrintit



PROJEKT KONSERVIMI DHE DRENAZHIMI NË "PORTËN ME KULLA DHE
NIMFEU", QYTETI ANTIK BUTRINT, SARANDË

3



Sarandë - Pika më e afërt automobilistike
17 km



PROJEKT KONSERVIMI DHE DRENASHIMI NË "PORTËN ME KULLA DHE
NIMFEU", QYTETI ANTIK BUTRINT, SARANDË

4



Hyrja e Parkut – Porta me Kulla
rrreth 420 metra



Porta me Kulla, strukturë e shek. 3 para Krishtit, është pjesë e Qytetit Antik të Buthrotit, i cili është shpallur për herë të parë Monument Kulturore nga Instituti i Shkencave, me Vendim nr. 95, datë 16.10.1948, shpallur Park Kombëtar dhe Sit i Trashëgimisë Kulturore Botërore i regjistruar në Unesco. Kjo portë është një nga hyrjet e murit rrëthues dhe ndodhet në anën jugore të qytetit të fortifikuar, e emërtuar e tillë nga autor i parë i zbulimit të saj, Piero Markoni në vitin 1937. Struktura e saj përbëhet nga dy kulla, një në formë katrore dhe një në formë patkoi, dhe korridori i krijuar midis tyre, me muraturë trapezoidale pseudo-izodomike. Gjatë vitit 1974 në këtë strukturë arkeologjike janë kryer punime restaurimi nga restauratori Guri Pani.

Zona përrreth është shumë e pasur me pasuri kulturore, ku në distancë ajrore të afërt gjenden: Kalaja e Ali Pashës, Muret antike në Dema, Manastiri i Shën Gjergjisë Kalaja e Kalivosë, e Malathresë, e Vagalatit, etj. Rruga automobilistike e asfaltuar përfundon shkon deri ne hyrje te parkut. Prej kësaj shkohet deri tek Porta me Kulla në një terren relativisht lehtë më këmbë.



Fig. 4 Pamje ajrore e pasurive kulturore përrreth






Fig. 5 Rilevime të vjetra të monumentit

D2_PËRSHKRIM HISTORIK

Butrinti, Buthrotum-i antik i shtrirë rreth 3 km nga ngushtica e Korfuzit, është vendosur në një kodër të vogël, rrrethuar nga ujrat e liqenit të Butrintit që lidhet me detin Jon nga kanali i Vivarit. Nga vodosja e tij strategjike Butrinti ka figuruar në historinë e Mesdheut që nga lufta e parë e Peloponezit në shekullin e 5-të para Kr. deri në lufrat e Napoleonit në shekullin e 19-të. Monumentet e tij të ndërtuara gjatë periudhave të ndryshme historike pasqyrojnë këtë histori të gjatë dhe komplekse. Rreth 18 000 vjet më parë, reliivi përreth Butrintit ishte shumë i ndryshëm nga sot. Niveli i detit ishte shumë më i ulët dhe ishulli i Korfuzit ishte i bashkuar me kontinentin. Pas 9 000 vjetësh, ndoshta nga lëvizjet tektonike, niveli i detit u ngrit dhe kodrat përreth, si Xarra, Shëndëllia, Shënmitri dhe Kalivoja, u kthyen në ishuj të vegjël. Zbulimi i veglave prej guri dhe stralli në këto ishuj dëshmon se kjo zonë ka qenë e banuar që në epokën e paleolitit.

Butrinti, si qytet, ka pesë pjesë kryesore, akropolin, qytetin që shtrihet kryesisht nga ana veriore, me pamje nga liqeni, agoranë në pjesën më të ulët në anën jugore, një lagje përtej kanalit të Vivarit si dhe nekropolin ose varrezat në shpatin e kodrës përballë, në anën perëndimore.

Akropoli përbën pjesën më të lartë të qytetit, ku gjendet një fortifikim i mesit të shek VII p.Kr me sipërfaqe 0.7 ha. Mbi bazën e tij është formuar qyteti i mirëfilltë rrëth fundit të shek.V p. Kr, i rrëthuar me një mur prej bloqesh të mëdha poligonale e trapezoidale, me gjatësi 700m.

Agoraja është zona shoqërore ku janë vendosur monumentet më të rëndësishme: teatri, tempulli i Asklepit, prytaneioni, stoa, etj si dhe më vonë gjatë periudhës Romake në këtë zonë përveç të tjera u ndërtuan termat, forumi dhe gjimnazi. Më në lindje të forumit ndodhet qendra bizantine me monumentet si pallati i trikonkës, pagëzimorja dhe bazilika e madhe.

Në burimet e shkruara Butrinti përmendet përfi herë të parë në shekullin e 6-të para Kr. në veprën "Europa" të gjeografit grek Hekateu i Miletit. Në fillimet e tij futej në bashkësinë e Kaonëve e më vonë në shtetin e Epirit. Në kohën e Jul Çezarit dhe Augustit u kthye në koloni romake. Më vonë hyri në zotërimet e Venedikut, prej të cilit e shkëputi Ali Pashë Tepelena. Me rënien e pashallëkut të Janinës, Butrinti kaloi nën sundimin osman, që zgjati deri në vitin 1913. Në vitin 1435 qëndroi në Butrint humanisti italian Qiriako d'Ankona, i cili përshkoi disa monumente që gjendeshin në tokë duke vlerësuar i pari rëndësinë e Butrintit si qendër arkeologjike. Ishte arkeologu italian Maria Luigi Ugolini, i cili në vitin 1928 realizoi që në fushatën e parë zbulime sensacionale si: Porta Skea, Pusi i Junia Rufinës, Banjat romake, Bابتisteri dhe mbi të gjitha Teatri, ku gjeti dhe skulpturën me kokën e Deas së Butritit.

Vendbanimi më i hershëm në Butrint ka të ngjarë të ndodhej në kodrën e Akropolit, një bërthamë e vogël e Epokës së Bronzit të Vonë mund të kanë zënë faqen dhe kulmin më të lartë lindor të kodrës.

Më vonë, gjatë periudhës helenistike, kur Butrinti dhe Kaonia u bënë pjesë e Epirit, qytetit u shndërua në një koinon vetqeverisës të quajtur Prasaib. Mbishkrimet janë një burim i pasur informacioni për mënyrën e qeverisjes së qytetit, si dhe për përkatësinë etnike të banorëve të Butrintit.

Gjatë pjesës më të madhe të historisë së tij të lashtë, Butrinti funksionoi si një qendër kulti kushtuar Asklepit, perëndisë së shëndetit. Shumë nga këto objekte janë zbuluar gjatë gërmimeve të bëra në faltore, në fund të viteve 1920.

Gërmimet e fundit arkeologjike, kanë treguar se qyteti gjatë periudhës romake u zgjerua dhe u shtri në Fushën e Vrinës, përtej Kanalit të Vivarit. Lagjia e re u ndërtua sipas një plani urbanistik. Butrinti lidhej me lagjen e re me anë të një ure dhe një ujësjellësi në katin e sipërm, një vepër e vërtet arkitektonike, që mundësonde furnizimin e Butrintit me ujë nga Xarra.

Në Diaporit, në bregun më të largët të Liqenit të Butrintit, u ndërtua një vilë madhështore, me ambiente luksoze dhe kopshte me pamje nga Liqeni.

Brenda në Butrint në Pallatin Trikonkë gërmimet dëshmojnë për një shtëpi e cila nga shekulli i 3-të pas Kr. u bë gjithnjë e më madhështore.

PROJEKT KONSERVIMI DHE DRENASHIMI NË "PORTËN ME KULLA DHE
NIMFEU", QYTETI ANTIK BUTRINT, SARANDË

7




Fig. 7 Harta e qytetit Butrint.

Në fund të shekullit IV-të e në vazhdim u ndërmorën rindërtime të ndryshme si në Pallatin Trikonkës. Por, në shekullin e 5-të pas Kr., Butrinti ra pre e dyndjeve shkatërruese vandale. U ndërtua një mur i ri fortifikues duke u shtrirë përgjatë gjithë bregut të kanalit, mbase nga frika e sulmeve vandale ose të Ostrogotëve.

Në Butrint në çerekun e dytë të shekullit të 6-të u ndërtua Baptisteri dhe Bazilika e Madhe.

Në fillim të shekullit të 7-të ishte një fshat i vogël mbi rrënojat e qytetit greko-romak. Në vend që të zihej akropoli, kalaja e Butrintit duket se ishte vendosur në dy kulla në anën perëndimore të qytetit të poshtëm përballë kanalit. Të dy kullat u dogjën dhe u rrëzuan dhe vulosën një sasi të



rrallë objektesh që datohen rrreth vitit 800. Gjatë shekujve 9 dhe 10 në mesin e rrënojave të qytetit antik gjendeshin banesa prej druri dhe komplekse kishash.

Riorganizime dhe rindërtimë duket se ka pasur gjatë periudhës së mesme Bizantine, u ngrit një qendër administrative lokale në një kompleks kishtar të rindërtuar në fushën e Vrinës.

Dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit 13-të ishin të trazuar për historinë e Butrintit e si pasojë ngritura e fortifikimeve të reja dhe restaurimi i atyre ekzistuese u bënë domosdoshmëri dhe morën hov. Në këtë kontekst u rifortifikuan pjesë të murit rrëthues të qytetit të poshtëm, atij perëndimor dhe kështjella në akropol. Pas vdekjes së mbretit Karl III Anzhu, Butrinti në vitin 1386 u ble nga Venecianët të cilët e mbajtën qytetin deri ne fund të shekullit të 18-ë. Butrinti u pushtua nga ushtarët e Napoleonit më 1796. Tokat përreth Butrintit u bënë pjesë e pronave të Perandorisë Otomane dhe vazduhan të ishin "turke" deri në 1912. Ali Pashë Tepelena i cili në 1807 ndërtoi një kështjellë në hyrje të kanalit të Vivarit për të parandaluar sulmet nga perëndimi.

03 ANALIZA E PËRGJITHSHME E MONUMENTIT

Pothuajse e gjithë linja e fortifikimeve të periudhave të ndryshme në akropol janë ndërtuar me blloqe të mëdha gëlqerore të punuara trashë. Sistemi i fortifikimeve është shumë kompleks sepse ka gjurmë të të gjitha periudhave të zhvillimit të Butrintit. Në fillim, ose mbase në mes të periudhës së hershme të hekurit, një shesh në të majtë të kodrës mund të ketë patur një mur mbrojtës. Ai ishte i ndërtuar me blloqe të mëdhenj në cepa të thyer kështu që mund të bashkoheshin njëri në tjetrit. Kjo pjesë u rindërtua pjesërisht më vonë, në shekullin I p.Kr. Blloket e përdorur në këtë rindërtim kanë dimensione të mëdha (rreth 2x1 m) dhe janë shumë të rëndë (4-5 ton) por janë të prerë me kujdes. Faqet janë të sheshta ndërsa blloket kanë formë të rregullta poligonale. Për një mbrojtje më të mirë, linja e drejtë e murit është ndërprerë me anë të frëngjive dhe kontrafortave.

Zhvillimi i qytetit dhe zgjerimi i tij drejt jugut në fillim të shekullit III p.Kr., bëri të nevojshëm ndërtimin, në një sipërfaqe të sheshtë të një muri të ri, e cila rriti hapësirën e qytetit. Ky mur i ndërtuar me blloqe guri me formë drejtkëndëshe me lartësi të njëjtë, rrrethon zonën e Faltores së Asklepit, Teatrin, Agoranë dhe vazhdon tek Porta me Kulla e periudhës helenistike. Rreth fundit të shek. V/fillimit të shek. VI përgjatë kontureve jugore dhe juglindore të gadishullit u ndërtua një mur i ri rrëthues që la jashtë hapësirës urbane të qytetit lagjen e Fushës së Vrinës, e cila dikur kishte qenë një pjesë përbërëse e Butrintit në periudhën romake. Ndërtimi i murit në antikitetin e vonë karakterizohet nga një larmi teknikash ndërtimi. Muret e fortifikimit perëndimor dallohen nga rreshta të ndërtuar me blloqe gëlqerore, pak të latuar, që lidhen me llac të bardhë.



PROJEKT KONSERVIMI DHE DRENASHIMI NË "PORTËN ME KULLA DHE
NIMFEU", QYTETI ANTIK BUTRINT, SARANDË



Fig. 7 Pamje e përgjithshme e Kullës në formë patkoi.



Fig. 8 Pamje e përgjithshme e Kullës në formë katrore.



Fig. 7 Pamje e përgjithshme e kalimit midis kullave.




Fig. 7 Pamje e përgjithshme e shtegut që të çon për në monument.



Fig. 8 Foto e vjetër e Kullës në formë patkoi, Arkivi i IKTK.



Fig. 8 Foto e vjetër e Kullës në formë katrore, Arkivi i IKTK.

□ 4 _ PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK DHE TEKNIKA E NDËRTIMIT

Porta me Kulla është ndërtuar në anën jugore të qytetit të fortifikuar, pas Portës së Luanit dhe portës Skea. Këto hyrje paraqesin elementët më të rëndësishëm dhe njëkohësisht më me interes të murit rrithues nga pikëpamja arkitektonike. Nga kjo hyrje ruhen akoma muret deri ne tre metra lartesi, qe lene të kuptohet qartë strukturën e saj të përbërë nga dy kulla dhe korridori i krijuar midis tyre. Njëra prej tyre ka formën e një patkoi dhe është më e madhe ndërsa tjetra formë katrore.

Kulla në formë paktoi ka një gjatësi brinjësh 11 m dhe dy hyrje (Porta nr. 1 dhe 2). Muret e katit perdesha janë të trasha 1 m. Hapësira e brendëshme e kullës ndahet në 2 dhoma, të rreshtuara njëra pas tjetërs, afërsisht me madhësi të njëjtë. Hapësira 6 metra e arkitraut në këtë rast është përgjysmuar duke u mbështetur në kolona guri. Kolona në gjendjen e sotme arrin në lartësi 2.32 m, është e përbërë nga 4 blloqe gurësh të punuar në formë kuadrati, me seksion 40x40 cm. Kulla është e pajisur me frëngji, 4 për çdo anë të jashtme në katin e poshtëm dhe 1 frëngji në drejtim të korridorit të krijuar midis kullave, të cilat në planë kanë formën e gjurmës V, dhe përvçe funksionit të tyre të luftimit kanë shërbyer edhe për ndriçimin e ambientit. Ato arrijnë në lartësi 1m dhe formohen me 3 rradhë gurësh, dhe gjerësi deri ne 1 m nga brenda dhe deri në 12 cm nga jashtë.

Kulla në formë katrore përbëhet vetëm nga një ambient me përmasa 6.95x6.95 m. Hyrja bëhet nga ana veriore, e cila është e ndërtuar në qosehn VP, e mbështetur në murin anësor të kullës. Kjo kullë ndryshon nga forma dhe teknika e ndërtimit me kullën në formë patkoi. Muret janë ndërtuar me blloqe të mëdha prej guri gëlqeror, lartësia e rreshtit arrin deri në 64 cm, ndërsa gjatësia 1.3m. Këtu frëngjtitë formohen vetëm më dy rradhë gurësh. Në këtë kullë duket se kemi të bëjmë me një muraturë trapezoidale pseudo-izodomike. Blloqet e jashtëm të kullës janë më të mëdha se ato të brendshmit.

Duke krahasur teknikën e punimet të kullave me **kurtinat**, që lidhen me ndërtimin në të dy anët e saj, vëmë re dy periudha ndërtimit. Këtu gjerësia e murit është më e ngushtë se tek kullat dhe për lidhjen e tij shërbejnë blloqe të vetëm të vendosur gjatësor dhe têrthor murit.

Korridori ka një gjerësi 3 m dhe gjatësi 7.1m, e cila ka pasur një portë të dyfishtë, ku në muret e kullave duken gjurmët e portës së parë.

Gjatë vitit 1974, nga Guri Pani u realizuan ndërhyrje restauruese me të cilat u ribënen elementët e arkitrarëve të hyrjeve. Ato u realizuan brej b/arreje për të eleminuar zvendësimin e herëpashershëm që do të kërkonin arkitrarët e drurit. Për të ruajtur pamjen e parë të këtyre arkitrarëve, në anët e dukshme të tyre u vendosën trarë druri, të cilët mund të zvendësohen me kalimin e kohës, pa lëvizur gurët që ndodhen mbi ta.

05 ANALİZË E GJENDJES EKZISTUESE

PROBLEMATIKA STRUKTURORE DHE ARKITEKTONIKE

▪ Stuktura e përgjithshme

Struktura arkeologjike duket se nuk paraqet probleme, përsa i përket qëndrueshmërisë së saj. Megjithatë, si në të gjithë Butrintin, këto struktura janë në kontakt të vazhdueshëm me ujërat, një problematikë kjo e cila vjen nga vendndodhja e Parkut. Kështu edhe zgjidhet e këtij problemi duhen parë në tërësi, pasi realizimi i ndërhyrjeve pikësore nuk mund të jepin rezultat. Përgjithësisht në muraturë evidentohen prezencë e shumtë bimësie dhe patine biologjike.




Fig. 11 Kulla në formë patkoi.




Fig. 12 Kulla katrore.



Fig. 15 Pamje e arkitrarëve të betonit dhe mureve të rindërtuar sipër tyre.

■ Arkitrarët

Gjatë vitit 1974, nga Instituti i Monumenteve të Kulturës u kryen ndërhyrje restauruese për përmirësimin e gjendjes strukturore të Portës me Kulla, pasi në atë periudhë në të gjithë hapjet e dyerve kishte probleme me deformimin e strukturës së hapjeve (portave) duke rrezikuar në shembjen e muraturës dhe rënien e gurëve. Për rrjedhojë, u gjykuar që ndërhyrjet të realizoheshin me arkitrarë betoni e sipër tyre të bëhej anastiloza e muraturës ekzistuese, duke bërë numërimin e gurëve ekzistues dhe duke i vendosur më pas ata sipas pozicionit të tyre fillestar. Kjo ndërhyrje edhe pse një ndërhyrje që ka pasur përdorimin e elementëve ndërtimorë të papërshtatshëm, ka rezultuar efikase, pasi nuk janë evidentuar më rënie apo destabilitet të këtyre zonave.

■ Frëngjité

Po ashtu edhe frëngjítë nuk evidentohet të kenë probleme statike.



Fig. 15 Pamje e frëngjisë në kullën katrore.

▪ **Themelet**

Duke qenë se niveli i ujравe ishte mjaft i lartë në momentin e inspektimit, nuk ishte e mundur të identifikoheshin. Megjithatë duke e gjykuar strukturën nga muratura sipër nuk vihet re të ketë ndonjë ulje apo dëmtime të mundshme.

PROBLEMATIKA TË VIZITUESHMËRISË

I gjithë terreni përreth monumentit është i pasistemuar, me prezencë vegjetacioni të shumtë dhe i pa niveluar, duke vështirësuar aksesimin e tij e për rrjedhojë edhe leximin më të qartë të strukturës. E gjithë zona përreth ka nevojë për sistemim dhe nivelim të terrenit, heqje dherash, si dhe gërmime arkeologjike të cilat do të ndihmojnë në plotësimin e informacionit dhe krijimit të imazhit të plotë të strukturës e po ashtu dhe për gjetjen e mundshme të dyshemeve origjinale.

□ 6 _ NDËRHÝRJET RESTAURUESE TË PROPOZUARA

Projekti i konservimit dhe drenazhit në "Portën Me Kulla Dhe Nimfeu", Qyteti Antik Butrint, Sarandë, do të realizohet në dy faza. Faza e parë parashikon ndërhyrje tek Nimfeu, punime të cilat janë realizuar në vitin 2020, ndërsa faza e dytë parashikon ndërhyrje tek Porta me Kulla, për të cilën është hartuar ky projekt.

PROJEKT KONSERVIMI DHE DRENASHIMI NË "PORTËN ME KULLA DHE
NIMFEU", QYTETI ANTIK BUTRINT, SARANDË

15



Ndërhyrjet restauruese dhe mirëmbajtëse në këtë objekt konsiderohen tepër të domosdoshme. Këto ndërhyrje kanë për qëllim:

- Nxjerrjen në pah të strukturës dhe të teknikës së ndërtimit të saj;
- konservimin e monumentit
- menaxhimin e vegjetacionit;
- rritjen e vizitueshmërinë;
- vlerësimin arkitektonik të strukturës.

Objektivat:

- a. Pastrimi nga bimësia e lartë dhe e ulët e të gjithë strukturës. Kujdes të veçantë do ti kushtohet eleminimit të rrënjeve të cilat kanë depërtuar në strukturë;
- b. Pastrimi dhe sistemimi i territorit përreth strukturës duke zbankuar dherat e tepërt dhe duke realziuar një nivelim të terrenit për të lehtësuar aksesin në monument;
- c. Propozim për devijimin e ujrale që aktualisht mbulojnë strukturën.

□ 7 _ BIBLIOGRAFIA E KONSULTUAR

- 1 Guri Pani, Restaurimi i Portës me Kulla në Butrint, Revista "Monumentet" 11/1976 fq.35-44 ;
- 2 Neritan Ceka, Fortifikimi antik i Butrintit, Revista "Monumentet" 12/1976 fq.27-48;
- 3 Neritan Ceka, Butrinti dhe fortifikimet e tij, Revista "Monumentet" 28/1984/2 fq.163;
- 4 Crowson, Andrew., Butrinti Venecian (Venetian Butrint), Butrint Foundation, Tiranë: 2008;
- 5 Ugolini, Luigi M., Butrinti, Miti i Eneas, Gërmimet, Instituti Italian i Kulturës, Tiranë: 2000;
- 6 Hodges, Richard., Bowden, William., Lako, Kosta., Byzantine Butrint, Excavations and surveys 1994-1999, Cambridge University Press, 2004;
- 7 Inge Lyse Hansen, Richard Hodges., Roman Butrint, Oxbow Books, Britani: 2007;
- 8 Molla Nevila, Paris Francesca dhe Venturini Francesco "Muret rrëthuese të Butrintit" në Butrinti në shekuj, Tiranë 2011;
- 9 Belisa Muka, Enrico Giorgi "New research by the Albanian and Italian archaeologists in Butrint" 2015;
- 10 Arkivi IKTK-së.

Përgatiti Grupi i punës:

Ark. Rudina Papavasili

Ark. Llambrino Baballëku

Ing. Endrita Mulleti

Ark. Katerina Margariti

Denisa Shehu

Ak. Llambrino Baballëku

Digitally signed by
Llambrino Baballëku
Date: 2021.03.10
12.05.14 +02'00'

Katerina
Margariti
Digitally signed by
Katerina Margariti
Date: 2021.03.10
10.12.08 +02'00'

Endrita
Mulleti
Digitally signed by
Endrita Mulleti
Date: 2021.03.10
11.19.14 +02'00'

Ark. Llambrino Baballëku
Denisa Shehu
Ak. Llambrino Baballëku
Shehu
Digitally signed by
Denisa Shehu
Date: 2021.03.10
11.41.04 +02'00'
o